



Instituti i Trajnimit të Administratës Publike

Strategjia për implementimin e programit të trajnimit

2011-2013

*“Një vend që përgatitet për anëtarësim në Bashkimin Europian duhet që t’i çojë institucionet, sistemet administrative dhe kapacitetet menaxhuese në ato standarde që sigurojnë zbatimin efektiv të *acquis communautair*”.*

- Sfidat e Administratës Publikë

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2010-2013

Tabela e Përmbajtjes

1. Stadi aktual i Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP).....	5
2. Çështjet strategjike që përmbante Plani i Punës së ITAP 2006-2009, analizimi i arritjeve dhe i relevancave (Lidhje).....	8
3. Organizimi i ri i ITAP	10
4. E ardhmja e ITAP- drejtimi strategjik për zhvillim.....	12
5. Programi dhe strategjia e trajnimit 2011-2013	16
6. Monitorimi i trajnimit dhe vlerësimi i impaktit	23

Lista e shkurtimeve

CATS	Credit Accumulation Transfer Points
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Kordinimit të Ndhmës së Huaj
BE	Bashkimi Evropian
GoVNet	Networku qeveritar
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
SPI	Sistemi i planifikimi të integruar
NSDI	Strategjia nacionale për zhvillim dhe integrim
ANT	Analiza e nevojave për trajnim
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
SMEI	Mbështetës i Ministrisë së Integritimit Evropian

1. Stadi aktual i ITAP-it

1.1 *Vizioni dhe misioni*

Vizioni i ITAP-it

- Qendër kombëtare e praktikave më të mira në menaxhimin e Administratës Publike
- Promovues i vlerave më të mira të shërbimit publik
- Një zë informues dhe një forum për diskutime dhe debate rreth çështjeve të Administratës Publike

Misioni i ITAP-it

Misioni i ITAP-it rrjedh nga vendimi i 18 Nëntorit 2005 për funksionimin e ITAP dhe është:

“Të trajtojë nëpunësit civil, të rrisë aftësitë profesionale dhe të përmiresojë njohuritë bazë në mënyrë që çdo nëpunës civil të kontribuojë optimalisht në arritjet dhe qëllimet e institucionit ku ai bën pjesë”

ITAP-i gjithashtu ka formuluar dhe një mision të vetin i cili është:

“ITAP-i duhet të mbështesë reformimin dhe përmirësimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm dhe profesional nëpërmjet trajnimit e zhvillimit cilësor dhe gjithpërfshirës”

1.1 Drejtime të përgjithshme të aktivitetit

Bazuar në vizionin dhe misionin e tij, ITAP-i është udhëhequr nga prioritetet e mëposhtme qysh prej vitit 2006:

1. Rritje e efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike;
2. Përgjigje e sukseshme ndaj standardeve Evropiane dhe kërkesave të Integritetit;
3. Rritje e cilësisë së shërbimit civil dhe përgjegjshmërisë së tij si ndaj publikut të gjerë dhe ndaj klienteve të drejtperdrejtë; dhe
4. Përmirësim i tërë sistemit të rekrutimit të shërbimit civil, zhvillimit të karrierës dhe vlerësimit të performancës.

Ajo çka mund të mungojë dhe që është përmendur në Planin e Punës për periudhën 2004-2009 është mosqenia prioritet trajnimi i nëpunësve të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Plani i trajnimit të ITAP -it

Zhvillimi i kapaciteteve të ITAP-it bazohet në zhvillimin e një programi tre vjeçar trajnimi - si një bazë e cila është menduar të rishikohet vazhdimisht, të përditësohet dhe të përmirësohet në aspektin e përmbajtjes për të pasqyruar nevojat në ndryshim të sektorit publik. Programi i trajnimit sigurisht është ndryshuar, por duhet bërë më shumë në aspektin e konsultimeve dhe bashkëpunimeve me sektorin publik, të cilat duhet të jenë më aktive me qëllim që të pasqyrohen në plan dhe nevojat e reja të tyre.

Trajnimi i ITAP-it është financuar nga Buxheti i Shtetit dhe është plotësuar edhe nga fondet e donatorëve; këto fonde mund të përdoren për financimin e drejtpërdrejtë të kurseve të trajnimit gjithashtu dhe për hartimin e kurrikulave të reja. Të ardhura më të vogla vijnë nga institucionet në formën e pagesave direkte për trajnimin sipas nevojave.

Marrëdhëniet midis DAP-it dhe ITAP-it

ITAP-i është institucion në vartësi të DAP-it. Ai raporton në DAP. DAP-i më pas ka për detyrë t'i japë ITAP-it udhëzime në lidhje me politikën e qeverisë për trajnimin, nevojat për trajnim dhe zhvillimin apo aktivitetin e ITAP-it. Në lidhje me koordinimin me ministrinë e linjës, ITAP-i mund të kontaktojë çdo pjesë të sektorit publik në mënyrë të pavarur, por kur është fjala për direktiva, ekziston nevoja për përfshirjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të DAP-it.

ITAP-i - një nevojë për një institucion fleksibël

Që nga viti 2011, ITAP-i është i ndarë në 3 qendra funksionale nën drejtimin e Drejtorit:

- Trajnimi i përgjithshëm
- Pushteti Vendor
- Njësia Teknike (e cila nuk është përgjegjëse për zhvillimin e trajnimit)

Ka 13 pozicione që merren direkt me hartimin e trajnimit, zhvillimin, koordinimin dhe shpërndarjen.

E thënë jo zyrtarisht, ITAP-i mund të përdorë burimet e tij në një mënyrë fleksibël dhe të kalojë stafin në programe të ndryshme trajnimi. Ky fleksibilitet është i nevojshëm që ITAP-i për të përgjigjet shpejt nevojave të reja dhe me të mëdha për trajnime të vazhdueshme dhe të përshtatet ndryshimeve. Megjithatë, për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare, ky fleksibilitet është në realitet mjaft i kufizuar.

Në kuadrin e një plani trajnimi shumë më të zgjeruar të ITAP-it dhe të një përqëndrimi në fusha të reja të ndërtimit të kapaciteteve, ekziston një nevojë e qartë për të rritur kompetencat dhe numrin e personelit në fushën e integritimit European - dhe gjithashtu të rivlerësojë përdorimin efektiv të stafit të aktual.

Njohja e nevojave për trajnim dhe kërkesave të klientit

Një projekt i mëparshëm ka hartuar një manual për analizën Nevojave për Trajnim. Metodologjia e përfshirë në këtë manual është e një niveli të lartë dhe kërkon një analizë të thellë të organizatave që do të vlerësohen në lidhje me nevojat e tyre për trajnim. Është më e përshtatshme që ky manual të shërbejë si një instrument për vetë organizatën për të bërë një analizë të tillë, pasi ky është një proces që kërkon menaxhim dhe përfshirje të stafit, dhe bazohet në vlerësimet e performancës.

ITAP-i tani është pajisur me një manual më të përshtatshëm për të. Ky manual është përdorur nga ITAP-i gjatë 2010-ës. Me mbështetjen e konsulentëve e projektit, stafi i ITAP-it - ka shkuar në institucionet e përzgjedhura dhe ka kryer një analizë të shkurtër organizative, duke studiuar dokumentet dhe duke folur me menaxherët, dhe nga kjo ndërtoi një ANT bazuar në këtë metodologji.

Prandaj, ambicja për të bërë një analizë të gjerë të Nevojave për Trajnim u realizua vetëm në vitin 2010. Ndërkohë, ITAP-i kryen vlerësimin e kursit të trajnimit nga pjesëmarrësi, pas përfundimit të çdo trajnimi. Kjo bëhet pjesë e dokumentacionit të kursit.

Kapaciteti ITAP-it

Institucioni i ITAP-it ka marrë një mbështetje të konsiderueshme dhe cilësore nga projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm. ITAP-i si një organizatë udhëhiqet nga një plan pune i një cilësie të lartë që nuk ka nevojë për ndryshime të mëdha.

Një pjesë e stafit të ITAP-it ka shumë vite që punon për këtë organizatë, duke qenë në këtë mënyrë pjesë e mbështetjeve të mëparshme. Punonjesit janë të informuar, kanë përvojë dhe kanë shfaqur aftësi të konsiderueshme në pjesëmarrjen e tyre aktive në ANT-në e bërë në 2010-ën. Megjithatë, dhe në funksion të planit të ri të trajnimit të ITAP-it, është e nevojshme që stafi të ketë një zhvillim të mëtejshëm dhe të vazhdueshëm. Një fushë zhvillimi është rritja e kapaciteteve për të zbatuar saktë sistemin e vlerësimit të performancës, ku ITAP-i mund të bëhet shembull, duke patur plane zhvillimi për çdo punonjës të ITAP-it.

Me qëllim rritjen e cilësisë së produkteve të ITAP-it dhe rritje të pjesëmarrjes në kurset e ITAP-it, stafi duhet të jetë më aktiv dhe të punojnë në përputhje me strategjitë ekzistuese, duke u ndihmuar dhe nga kjo strategji.

ITAP- i ka të gjitha kapacitetet për të zhvilluar programet e trajnimit që u përgjigjen nevojave të klientëve të tij. Megjithatë në kuadrin e qëllimit dhe përmbajtjes së programeve të reja të trajnimit, menaxherët e trajnimit të ITAP-it kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve të tyre, në mënyrë që të marrin të gjitha përgjegjësitë konceptuale dhe menaxheriale për fushat tematike të trajnimit, për të cilat ata do të jenë përgjegjës.

2. Çështjet kryesore strategjike të përfshira në 2006 – 2009

Plani i Punës së ITAP, një analizë e ecurisë dhe relevancës

Analizat e mëposhtme paraqesin planin e punës të ITAP-it dhe progresin e bërë deri më tani:

Komponentë të Planit të punës	Komente mbi ecurinë
Ndryshimi i theksuar për të përmbushur kërkesat në rritje të specializuara për trajnim të krijuara nga MSA. Do të ketë një kërkesë të konsiderueshme për trajnimin në harmonizimin e proceseve institucionale.	Kjo ka ndodhur vetëm në një masë të kufizuar
Rritje të nevojës për trajnim si rezultat i shtimit të punonjësve të rinj dhe ndryshimeve herëpashershme të stafit. ITAP-i do ta arrijë këtë me trajnimin e menaxherëve të nivelit të mesëm.	ANT-ja e bërë nga ITAP-i dhe ministritë, nxorri në pah se ITAP-i duhet të jenë më i informuar. ITAP-i duhet të mbajë më shumë lidhje me DAP-in për të marrë informacion të përditësuar mbi numrin, nivelet përkatëse të personave në administratë, dhe parashikimet mbi lëvizjet e stafit nëpër institucione.
Spektori publik do ta ndryshojë fokusin nga kontrolli i burimeve në kontrollin e cilësisë së shërbimeve të parashikuara. Trajnimi i ri për të mbështetur këtë ndryshim është hartuar mbi: standardet e ofrimit të shërbimeve, kontrollin e cilësisë dhe praktikën dhe vlerat më të mira.	ITAP-i nuk ka paraqitur ndonjë analizë konkrete lidhur me këtë ndryshim, nëse ai ka ndodhur dhe çfarë shtrijre ka patur. ITAP-i ka nevojë të konsultohet me ministritë kyçe që nxisin këtë ndryshim dhe të analizojë se cilat mund të jenë nevojat për trajnim. ANT-ja e fundit ka evidentuar disa fusha të ndryshuara.
Kthimi i ITAP-it si një think-tank, në përputhje me misionin e tij. Kjo është shumë e rëndësishme, në mënyrë që ITAP-i të jetë një promotor i ndryshimit.	Nuk ka asnjë ndryshim të dukshëm në këtë drejtim. Kjo pjesë e planit të punës do të përmbajë edhe vendosjen e bashkëpunimeve dhe iniciativave të përbashkëta me universitetet.
Gjenerimi i burimeve të të ardhurave alternative, me qëllim që të jetë më pak i varur nga buxheti i shtetit. Ky ndryshim do të mbështetet nga vizioni i ITAP për të investuar në kapitalin njerëzor i cili do të mbështesë përsosmërinë.	Ka mënyra të ndryshme që mund të ndiqen për të përmbushur këtë ambicë: (i) donatorët të paguajnë kurset, (ii) të ofrohen trajnime për të cilat individët janë të gatshëm të paguajnë, (iii) të analizohet nëse institucionet shtetërore mund të paguajnë trajnimin, jashtë parashikimit të

	<p>kapacitetit të buxhetit të tyre (e cila mund të shkaktoje dhe pakësim të buxhetit aktual themelor të parashikuar)</p> <p>Prandaj, kjo është një fushë që kërkon analizë të mëtejshme, e cila megjithatë, nuk është konsideruar si një kusht për zbatimin e strategjisë së propozuar të trajnimit.</p>
<p>Arritja e akreditimit si një qendër kombëtare dhe ndërkombëtare e ekselencës në fushën e trajnimit të shërbimit civil dhe sektorit publik.</p>	<p>Nuk ka arritje konkrete</p>
<p>Zhvillimi i programeve të certifikimit të shërbimit civil dhe programeve të diplomave, të akredituara nga ITAP-i dhe Universiteti, në bazë të pikëve CATS.</p>	<p>Nuk ka arritje konkrete. Kjo ambicie mund të realizohet vetëm nëse do të zhvillohej një program trajnimi afatgjatë dhe i qëndrueshëm.</p>
<p>Zhvillimi i kapaciteteve të brendshme , aftësive dhe menaxhimit të burimeve të ITAP-it në mënyrë që të përmbushë sfidat në një mjedis që ndryshon.</p>	<p>Kjo është një ambicie e përgjithshme që është ende shumë e rëndësishme.</p>

Plani aktual i Punës në këndvështrimin e planit të ri të trajnimit të ITAP

- Plani i propozuar i trajnimit është plotësisht në përputhje me visionin, misionin dhe gjithashtu me direktivat aktuale strategjike të ITAP-it.
- Plani i propozuar është mbështetur në konsultimet e gjera të kryera me institucionet shtetërore, në lidhje me nevojat e tyre për trajnim. Kjo është realizuar në përputhje me strategjinë e re të vlerësimit të nevojave për trajnim dhe me planin që ITAP-i do të zbatojë në të ardhmen, duke siguruar përditësimin e planit të trajnimit në mënyrë të vazhdueshme. Duhet vënë në dukje se ITAP do të ofrojë trajnime të reja dhe asistencë për të gjitha institucionet shtetërore, në mënyrë që ato të përmiresojnë aftësitë e tyre në lidhje me analizën e ngritjes së kapaciteteve; pasi kjo është një përgjegjësi e tyre ndërsa ITAP-i mund të ofrojë ndihmën e tij nëse kërkohet.
- Gjatë procesit të konsultimeve të zhvilluara nga ky projekt, janë evidentuar fusha të reja dhe të larmishme. Përqëndrimi më i madh tani është tek trajnimi që mbështet përpjekjet dhe synimet e Qeverisë për të realizuar SKZHI-në dhe kontribuon në rritjen e kapaciteteve të Administratës Publike për të realizuar detyrimet që rrjedhin

nga MSA-ja. Trajnimet e ofruara nga ITAP-i kanë qenë të lidhura më shumë me zhvillimin e aftësive bazë në përgjithësi dhe me fushat e përgjithshme administrative. Zhvillimi i mëtjeshëm i kapaciteteve në këto fusha të reja është një sfidë e re për ITAP-in. Del në pah nevoja për një plan konkret veprimi dhe kjo strategji synon të përmbushë pikërisht këto nevoja.

- ITAP-i synon të mbetet një institut trajnimi për zhvillimin e aftësive të nivellit fillestar dhe të mesëm. Ai nuk ka për qëllim që të kthehet, në një të ardhme të afërt, në institucionin kryesor menaxhues të nivelit të lartë drejtues. Megjithatë ai i ka kapacitetet dhe do t'ju përgjigjet këtyre nevojave nëse do të ishte e nevojshme. Plani i trajnimit përfshin trajnime të veçanta që janë specifike për menaxherët e lartë. Ai gjithashtu do të organizojë sipas kërkesave seminare të niveleve të larta për çështje të rëndësishme që mund të dalin. Megjithatë kjo ambicje nuk i plotëson të gjitha nevojat që ka administrata për trajnimin në fushën e menaxhimit të lartë.
- Disa nga çështjet nëplanin e punës janë të lidhura më shumë me zhvillimin institucional të ITAP-it dhe ato janë më pak të rëndësishme në këndvështrimin e planit të ri të trajnimit. Megjithatë, ekziston një ndryshim midis objektivave të këtij plani pune dhe strategjisë së ITAP-it, në mënyrë që të arrihet suksesi në realizimin dhe marketimin e planit të ri të trajnimit. Disa nga komponentet e planit të ri të trajnimit janë të fokusuar më shumë drejt përmirësimit të ITAP-it si një institucion. Ka ngjashmëri midis këtyre qëllimeve dhe planit aktual të trajnimit: ndryshimi qëndron më tepër në renditjen e prioritetëve.

3. Organizimi i ri i ITAP-it

ITAP-i aktualisht është i përbërë nga 3 qendra: Qeveria ka të ndërtuar një Akademi Fiskale jashtë ITAP-it dhe për këtë arsye njësia që mbulonte këtë fushë, nuk përfshihet më në strukturën e ITAP-it. Megjithatë plani i ri i trajnimit të ITAP-it përfshin trajnime të rëndësishme në fushën e menaxhimit financiar dhe menaxhimit të shpenzimeve publike që kërkojnë qajse në burimet e ITAP-it.

Një konkluzion është nevoja për të forcuar dukshëm fushën e integritimit në BE dhe të merret parasysh fakti nëse ITAP-i i ka kapacitetet për të zhvilluar dhe organizuar programet e propozuara të trajnimit mbi menaxhimin.

Formalisht, organizimi i ri i ITAP-it kërkon kohe, dhe duhen kaluar të gjitha fazat e buxhetit. Megjithatë, ITAP-i ka nevojë të përgjigjet menjëherë kërkesave të reja, sipas planit të trajnimit.

Është propozuar që ITAP-i, tani për tani të përdorë këto burime për të krijuar një staf efektiv rreth fushave të mëposhtme:

Temat e trajnimit të ITAP-it	Fushat e trajnimit të ITAP-it
Sistemi i planifikimit të integruar	Menaxhimi dhe Administrimi Publik
Prërgatitja për përfarimin e legjislacionit me <i>acquis communautair</i>	Integrimi Europian
Zhvillimi i BE-së, Institucionet dhe vendimarrja	Integrimi Europian
Politikat sektoriale të BE-së	Integrimi Europian
Procesi i integrimit në BE	Integrimi Europian
Instrumentet e financimit të BE-së, zbatimi i ndihmës (asistencës) së BE-së,	Integrimi Europian
Menaxhimi financiar dhe menaxhimi i shpenzimeve publike	Menaxhimi Financiar
Trajnime të përgjithshme dhe specifike	Menaxhimi dhe administrimi publik
Menaxhimi	Menaxhimi dhe administrimi publik
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerezore
Trajnime specifike	Trajnime institucionale dhe specifike
Zhvillimi i Qeverisjes Vendore	Qeverisja vendore

Aktualisht ITAP-i ka 13 pozicione për menaxherët profesional të trajnimit/administratorë, të ndarë këto në 2 qendra trajnimi. Janë propozuar 6 fusha funksionale. Çdo fushë kërkon të paktën një person të aftë profesionalisht për të drejtuar dhe një person tjetër si mbështetës.

Fushat që janë më të rëndësishme, në këndvështrimin e aftësive dhe peshës që zënë janë:

- Integrimi Europian
- Menaxhimi dhe administrimi publik
- Qeverisja vendore

Plani i trajnimit përfshin si trajnimin e detyrueshëm ashtu edhe trajnimin që do të zhvillohet në bazë të nevojave të kërkuara dhe mundësisë që ka sektori publik për të dërguar njerëz në trajnim. Në këndvështrimin e burimeve të kufizuara dhe duke marrë parasysh përmbajtjen e programit të trajnimit, ITAP-i duhet të përqendrohet gjatë vitit 2011 në trajnimet e detyrueshme që kanë dalë në disa fusha tematike.

Megjithatë, dhe në mënyrë që ITAP-i t'ju përgjigjet menjëherë nevojave për 4 fushat e trajnimit që lidhen me Integrimin në BE, në funksion të eksperiencës dhe kompetencave të kufizuara që ai ka aktualisht për këto trajnime është mëse e domosdoshme shtimi i burimeve të përshtatshme. ITAP-i duhet të rrisë interesin e donatorëve për ti ofruar eksperte, me

qëllim që të sigurojë organizimin dhe zhvillimin sa me cilësor të trajnimeve që qeveria të mundësojë shtimin e sfafit që duhet të punojë paralelisht me këta ekspertë.

4. E ardhmja për ITAP – Direktivat strategjike për zhvillim

4.1 Percaktim më mirë i roleve/profesioneve

Programi i ri i trajnimit kërkon më shumë aftësi dhe përkushtim të menaxherëve të trajnimit. Kjo pasi disa fusha janë të reja për ITAP-in si dhe pritshmëria për cilësi më të mirë të trajnimit është rritur. Kjo sfide e re e ITAP-it nuk do gjente zbatim nëse nuk do të mbështetej dhe zhvillohej nga menaxherët e trajnimit kompetente dhe të përkushtuar.

Ky rol i ri i menaxherëve të trajnimit do të krijohet kryesisht pasi:

- Menaxherët e trajnimit duhet të jenë ekspertë në fushat e trajnimit që ata mbulojnë. Këto aftësi kryesisht do të arrihen falë bashkëpunimit të vazhdueshëm me ekspertë nëpër ministri dhe gjithashtu nga venia në zbatim e njohurive të përfituara. Nëse stafi i ITAP-it merr përsipër gjithnjë e më tepër rolin e trajnerit për trajnimet në fushat e përgjithshme, kjo do të rrisë më tej aftësitë e tyre.
- Menaxherët e trajnimit duhet të rrisin aftësitë për të shkruar kurrikula gjithpërfshirëse (të plota) për kursin e trajnimit dhe termat e references për ekspertët dhe trajnerët.
- Menaxherët e trajnimit duhet të kenë më shumë iniciativë për të dalë jashtë zyrave të Institutit për të takuar klientët e tyre.
- Plani i ri i trajnimit është organizuar sipas fushave tematike të caktuara. Këto duhet të krahasohen me gjashtë fushat aktuale të aktivitetit të ITAP-it sot.
- Menaxherët e trajnimit që bëjnë pjesë në stafin e ITAP-it, besojnë se janë të aftë të rishikojnë dhe përmiresojnë trajnimin dhe të përcaktojnë se çfarë aftësie nevojitet në sektorin publik për të organizuar një trajnim të ri. Megjithatë, drejtori i ITAP –it duhet ti kontrollojë dhe ti drejtojë ata në mënyrë të vazhdueshme.
- ITAP-i duhet të krijojë një sistem për konsultimin me ekspertët dhe nëpunësit e administratës publike për t'u siguruar që kursi i trajnimit të ketë një përmbajtje të përshtatshme dhe të plotësojë nevojat për trajnim.
- Gjithashtu duhet të ndërtohet një sistem elektronik ku të përcaktohet metodologjia dhe hapat (check lists), që duhet të ndjekin menaxherët e trajnimit, për tu siguruar që pjesëmarrësit në trajnime të ndryshme të jenë njohur me programet e trajnimit të hartuar për ta, të risë interesin e tyre për trajnimet e ITAP-it dhe të bindin menaxherët që t'i lejojnë nëpunësit që të marrin pjesë në trajnim.

4.2. Objektivat kryesorë strategjike të zhvillimit institucional deri në vitin 2012

Objektivat kryesorë strategjike që synojnë ta orientojnë ITAP-in më shumë në drejtim të klientit dhe ta bëjë atë më aktiv në përmbushjen e vizionit dhe misionit të tij janë si më poshtë:

Objektivi 1 – Shndërrimi i ITAP-it në një institut të orientuar më shumë drejt klientit.

Roli i ITAP-it në hartimin e programeve të trajnimit për rritjen e kapaciteteve të administratës publike do të forcohet nëpërmjet adaptimit të metodave të orientuara drejt klientit dhe rritjes së rolit të menaxherëve të trajnimit në identifikimin e nevojave për trajnim. Drejtimet kryesore të aktivitetit të ITAP-it në tre vitet e ardhshme janë:

1.1 Organizimi i takimeve informative, të regullta zyrtare dhe jo zyrtare me menaxherët e burimeve njerëzore; kjo më pas kërkon krijimin e sistemeve për mbajtjen e këtyre kontakteve. Është e qartë se roli i menaxherit të burimeve njerëzore është kyç në kontaktet e regullta me ITAP-in. ITAP duhet të ftojë menaxherët e burimeve njerëzore në takime vjetore/6 mujore, për të diskutuar çështje me interes të përbashkët. ITAP-i duhet ti prezantojë vazhdimisht programet e trajnimit dhe të kryej takime për të parë nëse ka nevojë për ndryshime. Menaxherët e trajnimit, sipas fushave përkatëse që mbulojnë, duhet të evidentojnë se cilët janë personat përgjegjës në ministritë e linjës që mund të jenë të rëndësishëm në këtë proces.

1.2 Ministritë (institucionet) duhet të kryejnë vete analizën e nevojave për trajnim. ITAP-i duhet të nxisë ministritë që të kryejnë ANT më të regullta çdo dy ose tre vjet. Mund të përdoret manuali i ANT –së dhe ITAP-i do të ofrojë mbështetjen e tij si konsulent dhe mbikqyrës i procesit. Në mënyrë që të sigurohet angazhim dhe rritje të njohurive rreth ANT-së, ITAP-i duhet që në bashkëpunim me ministritë e linjës ti kryej këto ANT për 1-2 vitet e ardhshme, sidomos për ministritë që nuk u përfshinë në këtë projekt.

Ecuria e aktivitetit të ITAP-it do të ndryshojë në sigurimin e përmirësimit (freskimit) konstant, të përvitshëm, të planit të trajnimit dhe do të përqëndrohet me qartë në zbatimin e trajnimeve mbështetës të SKZHI dhe MSA, duke patur në vëmendje komunikimin me ministritë kyçe dhe konsultimet me ministritë e linjës (institucionet). Përdorim më i mirë i kapaciteteve logjistike të ITAP-it për organizimin dhe përshtatjen e trajnimit sipas nevojave.

Menaxherët e trajnimit do të mbajnë pozicionin aktual dhe njëkohësisht duhet të duhet të rritet konsiderueshëm roli dhe funksionet e menaxherëve të trajnimit. Kjo do të fokusohet së pari në përmirësimin e kontrollit të cilësisë dhe në më shumë mjete e mënyra inovative (risi) për arritjen e aftësive më të mira të mundshme për zhvillimin e trajnimit. Stafi i ITAP-it duhet të ndjekë një program trajnimi për trajnerë në mënyrë që ata të fitojnë disa aftësi për të dhënë vetë trajnim. Është e rëndësishme të kuptohet që këto ambicje nuk përjashtojnë kontraktimin e trajnerëve jashtë ITAP-it.

Objektivi II – Përmirësimi i organizimit të brendshëm të ITAP me qëllim ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e trajnimeve në nivel strategjik, në kuadër të SKZHI-së dhe MSA -së

2.1 Ndryshimi i organizimit të ITAP-it për trajnime të nivelit strategjik në lidhje me SKZHI-në dhe MSA-në – kapacitetet e jashtëme dhe të brendëshme. Aktorët kryesorë që sigurojnë zbatimin e politikave në këtë fushë dhe përdorimin e sistemeve të monitorimit strategjik janë: DEBASKON, Ministria e Integritimit dhe Ministria e Financave. Nevojat ndryshojnë vazhdimisht sipas zhvillimeve të programeve të Qeverisë dhe Reformave. Roli strategjik i ITAP-it është të marrë pjesë në diskutime – të jetë keshillues dhe të mësojë nga komentet (feedback) – të hartojë plane më afatgjata për rritjen e kapaciteteve dhe të zbatojë disa nga këto plane. Rjedhimisht, njesia e trajnimit në ITAP-it për rritjen e kapaciteteve për nevojat e integritimit në BE duhet të forcohet në mënyrë të dukshme, në drejtim të numrit të punonjësve dhe aftësive. Plani i trajnimit kërkon gjithashtu një ekip të gjerë me ekspertë të huaj dhe vendas.

Objektiva III – Rritja e rolit të ITAP-it në zhvillimin e programeve të trajnimit të financuara nga ndihma e huaj.

3.1 Më shumë programe nxitëse për ofrimin e shërbimeve të trajnimit me projektet e financuara nga donatorët. Ky propozim ka për qëllim ta bëjë ITAP-in një Institucion trajnimi profesional për zhvillimin e sektorit publik. Arsyeja e këtij synimi është që ITAP-i të përfaqësojë një institut trajnimi të qëndrueshëm pas përfundimit të projektit, që është në gjendje të vlerësojë rezultatet e ngritjes së kapacitetit nga projekte të ndryshme dhe të sigurojë që njohuritë e përfituara të mos shkojnë dëm. ITAP-i duhet të jetë më aktiv në organizimin e projekteve të financuara nga donatorët me qëllim që të promovohet si ofrues ose organizues i projekteve në fushën e trajnimit.

Objektivi IV – Shndërimi i ITAP-it në një insitucion “think tank” dhe një forum për bashkëpunim.

4.1 Të bëhet një forum për diskutime informuese dhe debat publik: Një pjesë e vizionit të ITAP është të jetë një zë informues dhe një forum për diskutime dhe debate për çështje që lidhen me shërbimet publike. Kjo pjesë e vizionit nuk është kuptuar mirë jashtë ITAP-it dhe duhet të forcohet. ITAP-i mund të mendojë të përfshijë në program programe zhvillimi, 4-5 çdo vit, ku të diskutohen çështje me interes për administratën publike. Ky aktivitet mund të realizohet pa shumë investime. ITAP-i mund të ftojë Projekte të ndryshme për të prezantuar aktivitetet dhe rezultatet e tyre. ITAP-i me dëshirë mund të organizojë evente të tilla në fusha të ndryshme të sektorit publik. Është e nevojshme që ITAP-i të paguhet për këto shërbime.

4.2 ITAP-i të kthehet në një institut “think tank” dhe një forum për bashkëpunim. Kjo është pjesë e planit të punës së ITAP-it sëbashku me ambicjen për tu akredituar dhe për zhvillimin e kurseve pas universitare. Të tilla aktivitete mund të gjenerojnë të ardhura për ITAP-in. Kjo strategji trajnimi e propozuar sugjeron që ITAP-i të përqëndrohet në realizimin e qëllimeve të shprehura në planin e ri shumë ambicioz të trajnimit dhe të vlerësojë rezultatet në vitin 2012 dhe bazuar në këto rezultate të gjykojë mundësinë për t’u përballur me këto ambicje më të larta.

Objektivi V – Përdorimi i Teknologjise së informacionit dhe komunikimit (ICT) dhe përmirësimi i networkut për marketim.

5.1 Zhvillimi i rrjeteve të komunikimit : Analiza e kryer mbi nevojat për trajnim tregoi vlerat e përforcimit të kontakteve dhe ngritjes së rrjeteve. Menaxherët e TAP-it duhet të mbulojnë institucione të ndryshme të qeverisjes qendrore, të jenë përgjegjës dhe të vëzhgojnë se çfarë zhvillohet e re në këto institucione, cilat mund të jenë nevojat dhe cilët janë personat kyç në lidhje me aktivitetet e ITAP-it. Fokusi i punës së ITAP-it do të ndryshojë pjesërisht: Fushat tematike të reja do të mundësojnë krijimin e lidhjeve sipas institucioneve dhe midis institucioneve. Cilat do të jenë nevojat brenda një fushe trajnimi specifike dhe si mundet ITAP-i t’u përgjigjet këtyre nevojave?

5.2 Përdorim me efektiv i informacionit në formë elektronike dhe mjeteve të komunikimit: Faqja elektronike e ITAP-it, duhet të përditesohet dhe të modernizohet. Ajo duhet të jetë një instrument parësor i sektorit publik që të japë informacion të përshtatshëm dhe të menjëhershëm lidhur me shërbimet që ofron ITAP-i. Mënyrat e organizimit të faqes, duhet të jenë të tilla që të bëhen të ditura çfarë produktesh ofrohen nga ITAP-i për grupe të ndryshme të synuara. Përdorimi i sistemit të email-it GoVNET për përhapjen e informacionit lidhur me trajnimin do të jetë vendimtar në realizimin e objektivave të përfshira në strategjinë e ITAP-it, dhe në rritjen e aksesit të administratës publike për çështje që lidhen me trajnimet që ITAP-i ofron.

5.3 Kapacitetet e ITAP-it, për të përballuar këtë rol të ri dhe më të gjerë të tij. ITAP-i ka një staf të aftë i cili do të jetë në gjendje të marrë përsipër përgjegjësi të reja në realizimin e trajnimeve. Trajnimet do të fokusohen në rritjen e kapaciteteve të stafit të cilët do të jenë njëkohësisht edhe trajnerë në fushat e përgjithshme – kryesisht si një mjet për të kuptuar më mirë tematikat e ndryshme. Kur ITAP-it ti shtohen këto aftësi, do të jetë shumë e rëndësishme që ITAP-i të kërkojë cilësinë e duhur të stafit. Aktualisht, rëndësi të veçantë kanë aftësitë e stafit që merret me trajnimet brenda kuadrit të çështjeve të Integritimit në BE.

Me fillimin e zbatimit të planit të trajnimit, menaxherëve të trajnimit duhet t’u kërkohej që të studiojnë në detaje objektivat e fushave të trajnimit, për të siguruar aftësitë e nevojshme për zhvillimin e trajnimit, të sigurojnë cilësinë e trajnimit dhe të mbajnë kontakte profesionale

me ministrite e linjës që janë përgjegjëse ose që janë më shumë të përfshira në fushën përkatëse të trajnimit.

Nuk është e mundur realisht që ITAP-i të mund të menaxhojë këtë plan, i cili do të përfshijë realizimin e të gjithë programit të trajnimit, i cili është shumë ambicioz, me stafin që ka aktualisht. Në një periudhë afatgjatë, rekomandohet që të shtohen rreth 4-5 nëpunës të cilët të jenë përgjegjës për tematikat që lidhen me integrimin në BE. Ky do të jetë një fillim i ri.

Stafi aktual është i aftë të marrë përgjegjësitë për realizimin e trajnimeve në fushat e tjera të trajnimit të cilat i përkasin atyre çka ITAP-i ofron aktualisht, megjithëse vetëm një pjesë e tyre janë kërkuar sërish.

ITAP-i duhet të mbështetet me mjete financiare të besueshme dhe në masë të konsiderueshme, që të mund të punojë në një situatë të favorshme dhe në terma afatgjatë. Këtu bëhet fjale jo vetëm për pagat, po gjithashtu edhe për shpenzimet e trajnimit. Me qëllim që të zbatohet plani i trajnimit, duhet që edhe donatorët të mbështesin një pjesë të strategjisë së re të ITAP-it, duke përdorur më gjerësisht burimet e ITAP-it në realizimin e trajnimeve të veçanta, dhe duke paguar për realizimin e këtyre shërbimeve.

Numri e trajnimeve është provuar se ka njohur rritje nga viti në vit. Kjo pasqyrohet në nevojën për të rritur kontributin e Qeverisë, në formën e dhënies të graveve në nivele më të larta ose në formën që organizatat e sektorit publik të planifikojnë një pjesë të buxhetit të tyre për rritjen e kapaciteteve dhe të paguajnë ITAP-in direkt.

5.Strategjia e trajnimit dhe programi për periudhën 2011 – 2013

5.1 Përse një program i ri dhe më i zgjeruar trajnimi?

Administrata publike Shqiptare po përballet me një nga proceset më të mëdha politike dhe historike të vendit, që lidhen me futjen e Shqipërisë në BE. Ky është një proces shumë i rëndësishëm dhe kompleks i cili kërkon kapacitete të përshtatshme të shërbimit civil dhe të nëpunësve të tjerë të sektorit publik, të cilët do të udhëheqin përpjekjet e vendit për realizimin e kësaj iniciative.

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të përgjithshme administrative në Shqipëri, përmes modernizimit të administratës publike Shqiptare, dhe forcimit të institucioneve kyçe, është ndër prioritetet kryesore të dokumentit të Partneritetit Europian, si edhe të Planit Kombëtar të Qeverisë Shqiptare për zbatimin e MSA-së.

Objektivi kryesor i programit të ri të trajnimit është: *të mbështesë një shërbim civil me profesional, të aftë dhe të bazuar në sistemin e meritës, menaxher më të zot dhe më të përgjegjshëm dhe një shërbim civil më të aftë dhe më të motivuar për të zbatuar strategji kombëtare për zhvillime të mëtejshme në të ardhmen.*

Themelore për këtë program trajnimi 3 vjecar është analiza e nevojave për trajnim. Konsultimi dhe mendimet e marra kanë bërë të mundur që programi i trajnimit të lidhet me së miri me nevojat e klientëve kryesore të ITAP-it.

Fillimisht ITAP-i ofronte kryesisht kurse trajnimi të përgjithshme, të cilat fokusoheshin në dhënien e njohurive bazë rreth mënyres se si është e organizuar administrata publike, cilat janë kërkesat e përgjithshme për të qenë një nëpunës civil. Në programin e ri të trajnimit ofrohen trajnime më të specializuara .Zhvillimet e reja të vendit kërkojnë një vision strategjik dhe rritjen e kapaciteteve, analizimin e situatës dhe ndërmarrjen e veprimeve për rritjen e kapaciteteve për të përballuar sfidat e reja.

ITAP duhet të punojë më shumë për të ngritur imazhin me qëllim që të kthehet në një qendër kombëtare për përhapjen e praktikave më të mira në menaxhim dhe administrim publik, një promotor i vlerave themelore të shërbimit publik, një burim informacioni dhe një forum diskutimi dhe debati për çështjet e shërbimit civil.

Prandaj, me qëllim që të arrihen këto objektiva, ITAP-i propozon një plan trajnimi 3 vjecar i cili u përgjigjet zhvillimeve ambicioze të shërbimit civil në administratën publike dhe arritjes së objektivit kryesor: integritit në BE.

5.2. Proçesi i analizës së nevojave për trajnim

Procesi i analizës së nevojave për trajnim nisi në Maj dhe përfundoi në Tetor 2010. ANT-ja u realizua në dy nivele:

Niveli Strategjik: me qëllim hartimin e një plani Qeverisë, gjithpërfshirës për ngritjen e kapaciteteve në nivel strategjik, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) si dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), u organizuan ndër të tjera dhe takime me: Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON), Ministrinë e Integritit si dhe Ministrinë Financave. Organizimi i këtyre takimeve pati për qëllim diskutimin e politikave dhe proceseve më të rëndësishme që organet qeveritare në nivel qendror po zbatojnë ose i kanë në plan për ti zbatuar në një plan afatmesëm.


Nivel ministrie: u organizuan takime me Departamentet e Burimeve Njerëzore dhe menaxherët e linjes në 4 ministritë e përzgjedhura¹. Me qëllim përcaktimin e nevojave të tyre me specifike në kuadër të prioriteteve të Qeverisë për rritjen e kapaciteteve-trajnime specifike- dhe me qëllim adresimin e trajnimeve sipas nevojave për realizimin e politikave dhe programeve të sektorëve të veçantë. Fushat e trajnimit të propozuara nga ministritë e linjës dhanë informacionin në lidhje me nevojat për trajnim sipas nevojave specifike.

Programi i trajnimit i hartuar sipas intervistave iu dërgua më pas të gjitha ministrive të linjës për rishikim apo komente të nevojshme. ITAP-i mori komentet dhe sygjerimet nga të gjitha institucionet. Kjo mënyrë gjithpërfshirëse ndihmoi në një hartim më të mirë të programeve të trajnimit, duke realizuar në këtë mënyrë programe që përshtaten më mire me nevojat e Qeverisë.

¹Ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Ekonomise, Tregëtise dhe Energjistikës, Ministria e Bujqësisë, ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.


Prioritetet e trajnimit

Programi i trajnimit të ITAP-it shtrihen në një periudhë tre vjecare, duke filluar që nga viti 2011. Ai është hartuar duke u mbështetur në 4 shtylla kryesore, duke e vënë më shumë theksin në trajnimin e nëpunësve civil të nivelit qendror, mbi çështjet që kanë lidhje me procesin e Integritimit në BE në të ardhmen.



ANT-ja e kryer dhe informacionin lidhur me nevojat kryesore në administratën publike- duke përfshirë gjithçka që ka lidhje me fushat prioritare për zhvillimin e kapaciteteve ashtu dhe me rritjen e aftësive. Megjithatë, disa fusha trajnimesh janë të lidhura me një grup të vogël nëpunësish. Në këndvështrimin e fushave gjithpërfshirëse të trajnimit, sikurse prezantohet dhe në grafikun e mëposhtëm, çështjet që kanë lidhje me Integritimin në BE do të kenë më shumë rëndësi në programet e trajnimit për tre vitet e ardhshme, duke mbuluar rreth 40 % të të gjithë kurseve të trajnimit.

Grafiku 1: Shpërndarja e kurseve të trajnimit sipas fushave tematike



1. Trajnim që lidhet me Procesin e integrimit European

Program i trajnimit në këtë fushë, përfshin kurse trajnimi të hartuara për nëpunës të sapo emëruar në Administratën Publike duke ofruar njohuri të nevojshme dhe informacion mbi historinë e krijimit të Bashkimit European, institucionet kryesore të BE-së dhe ato vendimarrëse, si edhe për nëpunësit aktuale në nivel qendror dhe lokal.

Trajnimi mbi harmonizimin e legjislacionit mbetet një fushë prioritare në programin e trajnimeve mbi çështje të BE-së. Në fokus të veçantë do të jenë kurset e trajnimit nëpërmjet të cilave administrata publike do të përgatitet të ndërmarrë procesin e negociimit në lidhje me politikat sektoriale të BE-së, me qëllim që të kuptohen sa më mirë natyra dhe konceptet e politikave të BE-së.

Me qëllim që të adresohen kërkesat mbi zbatimin e fondeve të BE-së dhe rritjen e kapaciteteve për zbatimin në të ardhmen të sistemit të decentralizuar të asistencës së BE-së, kurse trajnimi do të përgatiten për stafet e ministrive që punojnë me hartimin e projektpropozimeve, programimin dhe monitorimin e asistencës së BE-së.

Përveç përgatitjes për zbatimin e asistencës së BE në kuadrin e Instrumentit të Para-Aderimit, është zhvilluar një kurs trajnimi për hyrje në fondet strukturore të BE.

